3	Rajoni Jugperëndimor	3.340	221.899	66	13	8	286	36,1
4	Rajoni Juglindor	2.739	172.693	63	10	5	188	45,3
5	Rajoni i Pellagonisë	4.717	234.320	50	9	4	343	67,6
6	Rajoni i Pollogut	2.416	314.194	126	9	7	184	29,2
7	Rajoni Verilindor	2.310	174.876	75	6	3	192	56,6
8	Rajoni i Shkupit	1.812	601.057	319	17	7	142	71,8

Shkalla e zhvillimit të rajoneve të planifikuara<sup>2</sup>


Me qëllim të vendosjes së bazës për zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal, është bërë klasifikimi i rajoneve të planifikuara sipas shkallës së zhvillimit. Në vendimin për klasifikimin e rajoneve të planifikuara sipas shkallës së zhvillimit, të miratuar në vitin 2008, rajonet e planifikuara janë klasifikuar në këtë mënyrë:

Rajonet e planifikuara	Sipas indeksit zhvillimor	Sipas indeksit ekonomiko - social	Sipas indeksit demografik
Të Shkupit	<b>1,48</b>	1,86	1,25
Juglindore	<b>0,89</b>	1,38	0,58
Pellagonisë	<b>0,73</b>	0,79	0,69
Jugperëndimore	<b>0,72</b>	0,50	0,86
Pollogut	<b>0,72</b>	0,18	1,05
Vardarit	<b>0,69</b>	0,63	0,73
Lindore	<b>0,67</b>	0,95	0,50
Verilindore	<b>0,56</b>	0,33	0,70

Indekset e rajoneve të planifikuara vënë në dukje atë se sa rajonet ngecin në zhvillim krahasuar me mesataren e vendit me ç'rast:

- Indeksi 1 shënon se niveli i zhvillimit të rajonit të planifikuar është i barabartë me zhvillimin mesatar në nivel të Republikës së Maqedonisë;
- 
- Indeksi më i madh (më i vogël) se 1 do të thotë se niveli i zhvillimit të rajonit të planifikuar është më i lartë (më i ulët) se zhvillimi mesatar në nivel të Republikës së Maqedonisë.

## Rajoni i planifikuar i Pellagonisë



Rajoni i planifikuar i Pellagonisë përfshinë basenet e luginës së Pellagonisë dhe të Prespës dhe zë një sipërfaqe prej 4.717 km<sup>2</sup> ose 19% të territorit të Republikës së Maqedonisë, me çka paraqet një ndër rajonet më të mëdha në vend. Në këtë rajon hyjnë 9 komuna me 343 vendbanime, prej të cilave 338 janë vendbanime rurale.

Dendësia e popullsisë në këtë rajon është 50 banorë/km<sup>2</sup>, dhe është dukshëm më e vogël se mesatarja e vendit. Pjesa më e madhe e popullatës është përqendruar në dy komunat më të mëdha – në Manastir dhe në Prilep, ndërsa dy të tretat e komunave bien në zonën që ka popullzim të dobët.

Ky rajon në jug kufizohet me Shqipërinë dhe Greqinë. Komunikacionet zhvillohen përmes vendkalimeve kufitare: Stenje në Resnjë me Shqipërinë dhe Mexhitli në Manastir me Greqinë.

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Manastiri	787	93.646	66
2	Demir Hisari	480	8.881	41
3	Dolneni	412	13.703	37
4	Krivogashtani	89	5.893	13
5	Krusheva	191	9.588	19
6	Mogilla	255	6.553	23
7	Novaci	753	3.405	41
8	Prilepi	1.199	76.427	59
9	Resnja	551	16.224	44
	Gjithsej komunat e Pellagonisë:	<b>4.717</b>	<b>234.320</b>	<b>343</b>

### Resurset natyrore

Rajoni i planifikuar i Pellagonisë ka kushte të mira klimatike për zhvillimin e bujqësisë, posaçërisht për kultivimin e kulturave industriale, siç janë: drithërat (gruri, elbi dhe misri, panxharsheqeri, luledielli), duhani, prodhimet e kopshtarisë (speci, qepa) dhe pemëtaria (mollët). Kushtet e relievit në këtë rajon mundësojnë ujitjen e një pjese më të madhe të sipërfaqeve nga rrjedha e basenit të Černa Rekës (100.000 ha), ndërsa pyjet janë burim i prodhimeve të drurit dhe gjuetisë.

Nga minierat rëndësi të madhe për zhvillim ekonomik kanë shtresat e linjtit në Pellagoni dhe Mariovë, të cilat sot shfrytëzohen për në tri blloqet e TEC Bitolla dhe shtresat e jometaleve në vendin dyatomik në Manastirin – Mariovë dhe mermerët e bardhë në rrethin e Prilepit. Resurse të veçanta minerale paraqesin burimet e ftohta minerale në fshatin



Mexhitli të rrethit të Manastirit të cila janë në eksploatim.

Resurse më të rëndësishme ujore në rajonin e planifikuar të Pellagonisë janë lumi Cërna, potenciali i të cilit energjetik nuk është shfrytëzuar në mënyrë të mjaftueshme (akumulimet e Çebrenit dhe të Galishtes do të jenë hidroelektranat më të mëdha në vend) dhe Liqeni i Prespës, i cili paraqet motiv të posaçëm turistik për zhvillimin e turizmit veror në këtë rajon. Për ujitjen e sipërfaqeve të punueshme në këtë rajon posaçërisht janë të rëndësishme akumulimet e Strezhevës dhe Liqenit të Prilepit.

### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Në rajonin e planifikuar të Pellagonisë ekziston një trashëgimi shumë e pasur kulturo – historike e llojit të ndryshëm. Shquhet posaçërisht lokaliteti arkeologjik Heraklea, arkitektura e qytetit të Manastirit dhe kultura tradicionale e Krushevës. Qyteti i Manastirit njihet edhe si qendër e Alfabetit të gjuhës shqipe, si dhe e një numri të madh të kishave, xhamive manastireve, monumenteve urbane dhe rurale dhe kështu me radhë.

Në rajonin Trashëgimia natyrore është shumë e pasur – parku nacional Pelister, monumentet e shumta natyrore, prej të cilave dallohen Liqeni i Prespës, Kullat e Markos, disa rezervate natyrore dhe kështu me radhë. Llojllojshmëria dhe pasuria kulturo- historike dhe pasuria natyrore japin një potencial të lartë për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (liqeneve, malor, manastireve, turizmit të fshatit etj.), shfrytëzimi i të cilëve mund të kontribuojë në zhvillimin e këtij rajoni.

### Karakteristikat ekonomike

Rajoni i planifikuar i Pellagonisë ka PBV-në prej 3.577 € (viti 20093), që është pothuajse për 10% më e lartë nga mesatarja e Republikë së Maqedonisë. Me këtë, ai gjendet në vendin e dytë të zhvillimit nga tetë rajonet e planifikuara në Republikën e Maqedonisë dhe merr pjesë me 12,5% në krijimin e PBV-së. Si sektorë më të rëndësishëm në rajon dallohen: energjetika dhe industria ushqimore, e tekstitit, e duhanit dhe e ndërtimeve.


### Prioritetet e zhvillimit në rajon gjatë viteve 2010- 2010

1. Përmirësimi i lidhshmërisë së ndërsjellë dhe ndërkom-bëtare e komunave në rajon përmes planifikimit dhe ndërtimit të infrastrukturës bashkëkohore.
2. Mjedisi më i mirë jetësor përmes uljes së ndotjes, shmangies së pasojave nga ndotja, si dhe rritja e efikasitetit të energjetikës.
3. Rritja e cilësisë së jetesës dhe kohezioni më i madh jetësor në rajon, përmes investimeve të vazhdueshme në zhvillimin e resurseve njerëzore.
4. Zhvillimi ekonomik rajonal në Rajonin e planifikuar të Pellagonisë.

Qendra për zhvillimin e rajonit të planifikuar të Pellagonisë  
[www.pelagonijaregion.mk](http://www.pelagonijaregion.mk)



## Rajoni i planifikuar Jugperëndimor



Rajoni i planifikuar Jugperëndimor shtrihet në zonat kodrinoro – malore, ku dominojnë male të larta me një lartësi prej mbi 2000 m. Në këtë rajon më e madhe lugina e Ohrit – Strugës e shtrirë midis maleve Jabllanica dhe Galiçica, e cila në një pjesë të saj plotësohet me Liqenin e Ohrit.

Në territorin prej 3.340 km<sup>2</sup>, në 286 vendbanime jetojnë gjithsej 221.899 banorë ose rreth 11% e popullsisë së përgjithshme në vend. Në pikëpamjen e shpërndarjes së popullatës, karakteristik është dallimi ndërkomunal dhe dallimi i vendbanimeve. Në tri komunat e këtij rajoni - Strugë, Ohër, Kërçovë jetojnë më shumë se 67% e popullatës së përgjithshme në vend. Denduria mesatare e popullatës në rajonin jugperëndimor është 66,4 banorë /km<sup>2</sup>.

Rajoni në perëndim dhe në jug kufizohet me Shqipërinë, me ç'rast në territorin e rajonit të planifikuar gjenden dy vendkalime kufitare: Shën Naumi dhe Qafa e Thanës dhe dy vendkalimet afër Liqenit të Ohrit, përkatësisht afër Ohrit dhe Strugës.

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	vevçani	23	2.495	1
2	Vraneshtica	109	1.282	15
3	Dibra	146	20.148	18
4	Devarca	425	4.799	30
5	Drugova	383	3.004	28
6	Zajasi	161	11.845	13
7	Kërçova	49	30.213	7
8	Makedonski Brodi	889	6.633	51
9	Oslomej	121	10.592	16
10	Ohri	390	54.901	29
11	Pllasnica	54	4.757	4
12	Struga	483	64.365	51
13	Qendra e Zhupës	107	6.865	23
	Gjithsej rajonet jugperëndimore:	<b>3.340</b>	<b>221.899</b>	<b>286</b>

### Resurset natyrore

Rajoni i planifikuar Jugperëndimor është i pasur me ujë dhe pyje të cilat janë nën mbrojtje të posaçme. Rajoni jugperëndimor është zonë më e pyllëzuar në Maqedoni dhe bart 21% të pyjeve në vend, me ç'rast pisha e zezë dhe druri i ahut mbulojnë 66% të sipërfaqes së saj. Lumenjtë më të rëndësishëm janë Treska dhe Drini i Zi, të cilët me potencialin e tyre mundësojnë ngritjen e tri akumulimeve në këtë rajon: Gllboçica dhe Liqeni i Dibrës në Drinin e Zi dhe Kozjaku në Treskë.





Në rajonin Jugperëndimor shtrihen rreth 10% e sipërfaqes së përgjithshme punuese në Maqedoni, ku më shumti prodhohet gruri, misri dhe patatja, kurse nga pemëtaria rendimentet më të mëdha janë të mollës, kumbullave, dardhave dhe qershisë.

### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Rajoni Jugperëndimor posedon një trashëgimi kulturo – historike me rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Ohri bashkë me rrethinën është qendër alfabetit sllav, ndërkaq këtu dallohet arkitektura e vjetër e qytetit dhe numri i madh i kishave dhe xhamive.

Liqeni i Ohrit, si një ndër liqenet më të vjetra në Europë, paraqet motiv të veçantë turistik për zhvillimin e turizmit veror në këtë rajon. Nga numri i përgjithshëm i shtretërve në Maqedoni (26.503), madje 16.400 përkatësisht 62% janë në rajonin e planifikuar, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në dy qendrat më të mëdha turistike në shtet – Ohri dhe Struga, të cilët shtrihen në bregun e liqenit të Ohrit. Ky rajon është i pasur me kafshë në rezervatin “Jasen” dhe vendet e gjahut Ramne, Trbole dhe Tazhevë, dhe disponon edhe me objekte për përkrahjen e gjuetisë. Rajoni Jugperëndimor

### Karakteristikat ekonomike

Rajoni Jugperëndimor ka një PBV prej për banorë (viti 20093), që për 30% është më e ulët se mesatarja e Republikës së Maqedonisë. Merr pjesë me 7,6% në krijimin e PBV-së dhe gjendet në grupin e tetë rajoneve të planifikuara, zë vendin e gjashtë të zhvillimit në Republikën e Maqedonisë. Vend të rëndësishëm në ekonominë e këtij rajoni zë turizmi, industria e përpunimeve, energjetika, sektori financiar, dhe pjesërisht bujqësia dhe peshkataria. Këtë rajon e vizitojnë 47% e të gjithë vizitorëve në Maqedoni, me ç'rast realizohen mbi 1.300.000 bujtje nga mysafirë të vendit dhe të huaj (65% të bujtjeve janë në nivel të vendit).

### Prioritetet e zhvillimit


1. Rritja ekonomike e arritur me nivelin cilësor të njohurive dhe shkathtësive të kapitalit njerëzor., ndërmarrjet e zhvilluara të vogla dhe të mesme dhe prodhimet e njohura lidhur me prejardhjen gjeografike të rajonit.
2. Vendi me një rrjet rrugor të zhvilluar dhe bashkëkohor, me një menaxhim të qëndrueshëm të potencialit të ujërave, in-

frastrukturë të zhvilluar arsimore dhe informatiko – komunikuese.


3. Agrobiznesi i bazuar në konceptin bashkëkohor të prodhimit të produkteve të njohura bujqësore për rajonin dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural i bazuar në njohuritë dhe teknologjitë bashkëkohore.
4. Destinacioni atraktiv turistik me një ofertë të integruar turistike, të bazuar në shfrytëzimin dhe mbrojtjen e qëndrueshme të pasurisë kulturore dhe natyrore.
5. Rajoni i pastër ekologjik me ujëra të mbrojtura, ajër dhe tokë, sistemi i integruar i menaxhimit të hedhurinave dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm e burimeve të përtëritura të energjisë.
6. Infrastruktura e zhvilluar sociale, me rrjetë të shërbimeve efikase, për një jetë dinjitoze dhe standard të qëndrueshëm për jetesë. Agrobiznesi

Qendra për zhvillimin e rajonit të planifikuar Jugperëndimor

[www.southwestregion.mk](http://www.southwestregion.mk)



## Rajoni i planifikuar i Pollogut



Rajoni i planifikuar i Pollogut gjendet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë, dhe shtrihet në drejtimin verijug të territorit në 2.416 km<sup>2</sup>. Ky rajon përfshinë Luginën e Pollogut, rrafshnaltën e Mavrovës, masivin malor Bistra dhe luginën e lumit Radika.

Këtë rajon e përbëjnë 9 komuna, ku në 184 vendbanime jetojnë gjithsej 314.194 banorë. Pjesa më e madhe banorëve është përqendruar në dy komunat më të mëdha: Tetovë dhe Gostivar, kurse denduria mesatare është 126 banorë/ km<sup>2</sup>, gjë që e bën rajon më të dendur pas rajonit të Shkupit.

Ky rajon në përfundim kufizohet me Republikën e Shqipërisë, kurse në veri me Republikën e Kosovës, me ç'rast në territorin e këtij rajoni ekziston një vendkalim kufitar me Republikën e Kosovës: vendkalimi kufitar në Jazhincë.

### Resurset natyrore

Kushtet e volitshme klimatike, si dhe reliefi i rajonit të planifikuar të Pollogut, mundësojnë kushte për zhvillimin e bujqësisë. Kulturat të cilat kultivohen në këtë rajon janë me një shije dhe kualitet të veçantë, kurse si brende janë të njohur në vend dhe më gjerë: mollët, grosha, speci dhe patatet e Tetovës, qengji i Sharrit, djathi dhe kaçkavalli i Mavrovës, mjalti i Sharrit etj. Territori i rajonit të Pollogut është rajon shumë i pasur me rrjedha të përhershme dhe të kohëpaskohshme të pasura me ujë gjatë tërë vitit. Lumenjtë në rajonin e Pollogut janë: Vardari, Shkumbini dhe Radika, të cilët përafërsisht janë të pasur edhe një fond të peshqve, me troftë dhe mrenë.

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Bogovina	142	30.102	14
2	Bërvenica	164	16.411	10
3	Vrapçishta	158	26.719	15
4	Gostivari	513	82.469	35
5	Zhelina	201	26.579	18
6	Jegunovca	177	10.855	17
7	Mavrova - Rostusha	663	8.823	42
8	Tearca	1377	22.723	13
9	Tetova	2622	89.513	20
	Gjithsej rajonet e Pollogut:	<b>2.416</b>	<b>314.194</b>	<b>184</b>





### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Trashëgimia natyrore është posaçërisht e pasur – parku nacional Bistra, Mali Sharr, lumenj me fond të pasur peshqish, liqene glaciale dhe natyrore, si dhe dy qendra të skisë (Kodra e Diellit dhe Mavrova).

Më parë Tetova ishte një nga qytetet më të vjetra në Maqedoni me një përzierje të fuqishme të kulturave gjatë kohërave të ndryshme. Me hyrjen e Perandorisë osmane në Ballkan, Tetova bëhet qendër administrative të cilën e zbkurojnë: Arabatî Baba Teqe, Xhamia e Larme, kalaja dhe të tjera.

### Karakteristikat ekonomike


Rajoni i Pollogut ka një PBV prej 1.531 € për banor (viti 20093) dhe merr pjesë me 7,2% në krijimin e PBV-së maqedonase. Me një PBV prej 53,1% më të ulët se mesatarja e Republikës së Maqedonisë, gjendet në vendin e fundit për nga zhvillimi në grupin e tetë rajoneve të këtij rajoni. Sektorët më të rëndësishëm të rajonit janë: industria përpunuese, ndërtimore, metalurgjia dhe turizmi.




### Prioritetet e zhvillimit

1. Të rritet niveli i zhvillimit ekonomik përmes rritjes së konkurrencës dhe produktivitetit.
2. Ta përmirësojë infrastrukturën ekzistuese dhe ta zhvillojë infrastrukturën e re transportuese, agrare dhe të komunikacionit.
3. Të avancohet mjedisi jetësor rajonal dhe të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm rajonal.
4. Të ngitet niveli i arsimimit të popullatës dhe të përmirësohet zhvillimi i resurseve njerëzore.
5. Rajoni i Pollogut të bëhet rajon udhëheqës bujqësor me një zhvillim të shpejtë rural.
6. Rajoni i Pollogut të bëhet qendër më e njohur turistike rajonale malore.
7. Përmirësimi dhe rritja e përfaqësimit të grupeve të marginalizuara në arsim, kulturë dhe fuqia punëtore.

Qendra për zhvillimin e rajonit të planifikuar të Pollogut  
[www.pologregion.mk](http://www.pologregion.mk)



## Rajoni i planifikuar i Shkupit



	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Shkupi	571	524.575	53
	a) Aerodromi	22	72.009*	1
	b) Buteli	55	37.371*	4
	c) Gazi Baba	111	75.589	13
	d) Gjozë Petrovi	67	41.775	6
	e) Karposhi	35	60.298	2
	f) Kisella Voda	34	57.236*	2
	g) Sarai	229	38.222	22
	h) Qendra	7	45.362*	1
	i) Çairi	4	64.823*	1
	j) Shuto Orizari	7	20.800*	1
2	Haraçina	31	12.565	4
3	Iliđeni	97	16.493	12
4	Petroveci	202	8.641	16
5	Zelenikova	177	4.563	14
6	Sopišta	222	5.656*	13
7	Studeniçani	276	19.133	19
8	Çuçer - Sandeva	241	9.431	12
	<b>Gjithsej komunat e Shkupit:</b>	<b>1.812</b>	<b>601.057</b>	<b>142</b>

Rajoni i planifikuar i Shkupit përfshinë basenin e Luginës së Shkupit dhe zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.812 km<sup>2</sup> ose 7% të territorit të Republikës së Maqedonisë. Këtë rajon e përbëjnë 17 komuna (prej të cilave 10 janë pjesë të qytetit të Shkupit) dhe qyteti e Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale me gjithsejtë 601.057 banorë.

Denduria e popullatës është 319 banorë/km<sup>2</sup>, dhe është katër herë më e lartë se mesatarja e vendit (81 banorë/ km<sup>2</sup>). Në qytetin e Shkupit është përqendruar rreth 71,8% e popullatës së rajonit, përkatësisht 21,5% e popullatës së përgjithshme në vend, gjë që vë në dukje përqendrimin e madh të popullatës në aglomeracionin e Shkupit.

Në rajonin e Shkupit gjendet edhe vendkalimi kufitar me Kosovën në Bllacë dhe aeroporti "Leka i Madh".

- Këto të dhëna të popullatës janë të vitit 2006



### Resurset natyrore

Kushtet e zhvillimit të bujqësisë në rajonin e Shkupit janë përafërsisht të limituara për shkak të nivelit të lartë të urbanizimit të rajonit dhe fragmentarizmit të të mbjellave bujqësore, që nuk shkon në dobi të zhvillimit intensiv të prodhimeve bujqësore. Në këtë rajon janë të përfaqësuara kryesisht kulturat bujqësore dhe në masë të caktuar edhe vreshtaria, ndërsa të pakta janë kulturat industriale dhe nuk ka ndonjë potencial të madh për zgjerimin e tyre.

Deri më tani nga xehet e gërmuara në minierave, rëndësi më të madhe ekonomike kanë shtresat e xehes së kromit në Radushë (komuna e Sarajit), kurse nga jometalet më të rëndësishme janë gurët e zbukuruar dhe travertinet në Kuçkovë dhe Sullare. Rëndësi të veçantë minerale kanë ujërat termale dhe termominerale në Katllanovë, të cilat japin mundësi për zhvillimin e turizmit të banjave në këtë rajon.

Resurs kryesor u ujit në Rajonin e Shkupit është lumi Vardar, me degët e Treskës, Lepencit, Pçinjës, Markova dhe Kadina Rekës. Në lumin Treska janë ndërtuar dy akumulime Matka 1 dhe konjaku, kurse në ndërtim e sipër është edhe Matka 2. Përveç potencialit hidroenergjetik, Treska dhe Kadina Reka me bukuritë e tyre ambientale ofrojnë kushte të jashtëzakonshme për rekreacion dhe zhvillimin e përmbajtjeve turistiko – hotelerike.

### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Nga trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike në rajonin e Shkupit, me potencialin e vet turistik shquhet lokaliteti arkeologjik Shkupi, Kalaja, Akuedukti, Çarshia e vjetër në qytetin e Shkupit, xhamitë dhe kishat e shumta, si dhe disa rezervate natyrore dhe monumente të natyrës, nga të cilat potencial më të madh turistik kanë Matka dhe liqeni Treska.



### Karakteristikat ekonomike



Ky rajon është ndër rajonet më të zhvilluara në Republikën e Maqedonisë dhe merr pjesë me 45,5% në krijimin e PBV-së maqedonase. Rajoni i planifikuar ka një PBV prej 5.083 € për banor (viti 20093), që është për 5,8% më e lartë se mesatarja e Republikës së Maqedonisë. Bartës të zhvillimit ekonomik në këtë rajon janë industria ushqimore, e tekstilit, e botimit, e përpunimit të metaleve, ndërtimtarisë, hotelerisë, tregtisë, transportit dhe shërbimeve afariste.

### Prioritetet e zhvillimit


1. Infrastruktura bashkëkohore transportuese, komunale dhe energjetike me një mbrojtje të plotë të mjedisit jetësor.
2. Mjedisi i shëndoshë dhe e i mbrojtur jetësor
3. Shfrytëzimi i mjeteve nga Instrumenti IPA.
4. Rritja e nivelit të zhvillimit ekonomik të rajonit përmes nxitjes dhe zhvillimit të MSP-së, industritë bartëse dhe shfrytëzimi i përparësive konkurruese të rajonit.
5. Shfrytëzimi dhe avancimi më cilësor i kapitalit njerëzor për qëllime ekonomike dhe avancimi i cilësisë së mbrojtjes shëndetësore dhe sociale.
6. Promovimi i bujqësisë moderne dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural.
7. Shfrytëzimi optimal i trashëgimisë natyrore dhe kulturo – historike në funksion të zhvillimit të turizmit.
8. Mbulesa më e madhe e rajonit me dokumentacionin hapësinor – planifikues dhe realizimi i tij e shpejtë dhe efektiv.

### Qendra për zhvillimin e rajonit të Shkupit

[www.rdc.mk/skopje](http://www.rdc.mk/skopje)



## Rajoni i planifikuar Verilindor



Rajoni i planifikuar Verilindor përfshinë komunat në pjesën e fundit verilindore të vendit, në trekëndëshin përgjatë kufirit me Kosovën, Serbinë dhe Bullgarinë. Sipërfaqja e përgjithshme e rajonit është 2.310 km<sup>2</sup>, përkatësisht 9% e territorit të përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë.

Në përbërjen e rajonit të planifikuar hyjnë 6 komuna me 174.876 banorë. Pjesa më e madhe (189) e vendbanimeve (192) janë vendbanime rurale, me ç'rast denduria e popullatës është 75 banorë/ km<sup>2</sup> dhe është shumë e ngjashme me mesataren e vendit (82).

Në këtë rajon të planifikuar janë thekuar dallimet në zhvillimin e popullatës. Te gjysma e komunave është e pranishme ulja e numrit të popullatës (Rankovci, Staro Nagoriçane dhe Kratovë), në njërin minimal, kurse në dy të tjerat shënohet rritje shumë e madhe (Likovë dhe Kumanovë).

Komunikimi me venet fqinje realizohet përmes vendkalimeve rrugore kufitare: Tabanovci, - Kumanovë dhe Prohor Pçinski – Staro Nagoriçane në drejtim të Serbisë dhe Deve Bair – Kriva Pallankë në drejtim të Bullgarisë.

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Kratova	375	9.887	31
2	Kriva Pallanka	480	20.440	34
3	Kumanovë	509	107.211	48
4	Likovë	273	29.058	22
5	Rankovci	241	3.873	18
6	Staro Nagoriçane	432	4.407	39
	Gjithsej rajonet e në pjesën Verilindore:	<b>2.310</b>	<b>174.876</b>	<b>192</b>

### Resurset natyrore

Masivi malor i Osogovës konsiderohet ndër fushat më të rëndësishme të xehetarisë në Republikën e Maqedonisë me minerale të: bakrit, plumbit, kromit, arsenit, antimonit dhe zinkut. Miniera Toranica (Kriva Pallankë) është e pasur me xehe




gjeologjike, rezervat e të cilës (bakrit, plumbit, kromit dhe argjendit) janë vlerësuar për 50 vjet eksploitim normal, kurse miniera e Llojanit (Likovë) është e pasur me arsen, antimon dhe krom. Në këtë rajon ka shumë miniera të jometaleve (deltina betoni, kuarc, tokë dyatomike, dhe aluvione ranore), para së gjitha në komunën e Kratovës me rezerva për 50 vjet eksploitim.

Ky rajon lumenjve përfshinë zonat e baseneve të lumenjve Pçinja dhe Kriva Reka, kurse në strukturën e vet (posaçërisht në Osogovë) përmban burime të ndryshme të ujit, dy liqene atraktive akumuluese artificiale (Likova dhe Gllazhnja në Komunën e Likovës) edhe dy akumulime më të vogla (Bazjačko Bërdo dhe Vllashki Kilibi në Kriva Pallankë).

Për shfrytëzimin e potencialit të ujërave të Lumit Zletova, në ndërtim e sipër është ndërtimi i hidrosistemit rajonal Zletovica për rajonin e Lindor dhe Verilindor, i cili do të sigurojë ujë për pije për më shumë se 200.000 banorë.

Ky rajon nuk është specializuar për kultura të caktuara bujqësore dhe nuk shënohen të ardhura të mëdha. Kohën fundit, prodhimtaria organike bujqësore plotësohet me prodhime organike të blegtorisë, sepse pjesëmarrja madhe e livadheve dhe kullsave e bëjnë këtë rajon të qëlluar për zhvillimin e blegtorisë. Vjelja e frutave malor, kërpudhave, bimëve shëruese dhe llojet tjera të bimëve, paraqet një veprimtari plotësuese për popullatën lokale.



### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike


Me të rëndësi të posaçme në këtë rajon janë kishat dhe xhamitë, si dhe komplekset e manastireve.: Manastiri i Osogovës, manastiri në fshatin Mateç, kisha "Shën Gjorgji" në Staro Nago-riçane, xhamia e Tatar Sinan Pashës e shekullit 16 në qendër të Kumanovës, xhamia në Tabanovc e ndërtuar në shekullin 13 dhe të tjera, ku karakteri i jashtëzakonshëm historik, arkitektonik dhe shpirtëror i tejkalon mundësitë e shfrytëzuara turistike deri më tani. Kështu, observatoriumi KOKINO, lokalitetet Kuklica dhe Gradishte, arkitektura e vjetër e Kratovës, si dhe disa rezervate natyrore (Ploçe Pitotelmi, si rezervat kryesisht natyror, ku zhvillohet popullata e vetme botërore e llojit të relikteve) dhe monumentet e natyrës e bëjnë rajonin e planifikuar të veçantë sipas vlerës së vet të pasur me trashëgimi kulturore dhe i japin një përparësi të dukshme krahasimtare para të tjerëve, duke pasur parasysh faktin për vendosjen e tij dhe afërsinë e kufijve të shteteve tjera.



Observatoriumi astronomik Kokino daton nga viti 1800 para erës sonë (që nga koha e hershme e bronzit), dhe llogaritet ndër observatoriumet më të vjetra në botë. Agjencia astronomike amerikane NASA e ka radhitur KOKIN-on në vendin e katërt në listën e 15 observatorimeve të tilla botërore, pas 1. Abus Sibleit në Egjipt, 2. Stounhenxhit në Britani të Madhe dhe 3. Angkor Vat-it në Kamboxhia. Fakti për një unikat të tillë botëror i rëndësisë së jashtëzakonshme, por janë të nevojshme investime plotësuese për shfrytëzimin e plotë të potencialit.

### Karakteristikat ekonomike

Rajoni i planifikuar Verilindor ka një PBV prej 1.707 € për banorë (viti 20093), që për 47,7% është më e ulët nga mesatarja e Republikës së Maqedonisë. Ky rajon më së paku se rajonet tjera të planifikuara (vetëm me 45%) në krijimin e PBV-së maqedonase, dhe sipas zhvillimit gjendet në vendin e parafundit në grupin e tetë rajoneve të planifikuara. Sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë në këtë rajon janë: industria ushqimore dhe e metaleve bashkë me industrinë kimie dhe tregtinë.




### Prioritetet e zhvillimit

1. Rritja ekonomike është më e madhe se rritja e shtetit në tërësi.
2. Infrastruktura bashkëkohore me rëndësi ndërkombëtare me përkrahjen e fondeve shtetërore dhe evropiane.
3. Mbrojtja e ambientit jetësor - investimi për pasardhësit tanë.
4. Zhvillimi i bujqësisë bazuar në njohuritë dhe inovacionet bashkëkohore.
5. zhvillimi rural dhe zhvillimi i turizmit - sfidat e reja për një jetë më të mirë në mjediset rurale.
6. Infrastruktura dhe shërbimet e zhvilluara sociale, çelës për një cilësi më të mirë jetese.

Qendra për zhvillimin e rajonit verilindor  
[www.northeastregion.gov.mk](http://www.northeastregion.gov.mk)

## Rajoni i planifikuar Lindor



Rajoni i planifikuar Lindor shtrihet në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë dhe përfshinë tërë rrjedhën dhe e lumit Bregallnica. Përfshinë 3.537 km<sup>2</sup> dhe përfshin 14% të territorit të vendit.

Ky rajon mbulon 11 komuna me 217 vendbanime, prej të cilave 209 janë vendbanime rurale. Numri i përgjithshëm i banorëve është 179.846, kurse denduria e popullatës 51 banorë/ km<sup>2</sup>. Vitet e fundit dëshmojnë për një proces të vazhdueshëm të shpopullimit, kështu që është numër i madh i fshatrave me madhësi prej 100 banorëve dhe fshatrave me një indeks të shprehur të plakjes. Kjo gjendje mundëson përqendrimin e 6% të popullatës në mjediset urbane.

Ky rajon i anës lindore kufizohet me Republikën e Bullgarisë, kurse komunikimi me shtetin fqinj realizohet përmes vendkalimit kufitar Dellçevë, në Komunën e Dellçevës. Ekziston mundësia për aktivimin e vendkalimeve kufitare Kllepallo, Ajudtska Çeshma dhe Cërna Skalla.

### Resurset natyrore

Kushtet klimatike në rajon janë të volitshme për zhvillimin bujqësisë, posaçërisht për prodhimin e orizit. Degë dominuese e bujqësisë është agrikultura përkatëse, përkatësisht kulturat e dritave: orizi, si më i rëndësishëm, elbi, gruri dhe misri. Fushat

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Berova	598	13.434	9
2	Vinica	433	19.513	16
3	dellçeva	422	17.017	22
4	Zërnovci	56	3.149	3
5	Karbinci	229	4.079	29
6	Koçani	360	38.170	28
7	Kamenica e Maqedonisë	190	7.880	9
8	Pehçeva	208	5.213	7
9	Probishtipi	326	15.694	36
10	Çeshinova – Obleshevë	132	7.264	14
11	Shtipi	583	48.433	44
	Gjithsej rajonet lindore:	<b>3.537</b>	<b>179.846</b>	<b>217</b>





e mbjella me oriz në këtë rajon prodhojnë rreth 95% të prodhimit të përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë. Përveç kulturës së drithërave, në këtë rajon zhvillohet edhe kopshtaria e hershme që bazohet në ujërat e ngrohtë nëntokësor, prodhimi i duhanit. Ky rajon, njëkohësisht është edhe prodhuesi më i madh i patates në shtet. Potenciali i madh për zhvillim dhe eksport vërehet te blegtoria – posaçërisht dhentë dhe dhitë. Potenciali është i madh për zhvillimin e industrisë së prodhimit të qumështit dhe mishit, sepse 40% e derrërisë realizohet në rajon.

Në lumin Bregallnica, si burim dominues i ujit në këtë rajon, ekzistojnë dy akumulime: “Kalimanci” dhe “Liqeni i Koçanit”. Rajoni lindor nuk resurse tjera më të mëdha ujore, furnizimi me ujë dhe ujësjellësi zgjidhen me ngritjen e akumulimeve të reja në lumin Bregallnica, si dhe në lumenjtë tjerë si Ziletovica (sistemi i Ziletovicës).


Nga territori i përgjithshëm i rajonit, 38% gjendet e mbuluar me pyje, që është 13% e pyjeve të përgjithshme



në Republikën e Maqedonisë. Nga lëndët e para dhe resurset tjera me të cilat disponon ky rajon, rëndësi më të madhe për këtë rajon kanë xehet e plumbit dhe zinkut në minierat e Ziletovës, Dobrevës dhe Kamenicës (me një prodhimtarë vjetor prej 1.000.000 tonë), kurse nga jometalet janë azbesti, argjila kaolin, si dhe shtresa e thëngjill – linjiti “BRik” në Berovë.

### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Trashëgimia natyrore është jashtëzakonisht e pasur, me çka krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit rural, por me rëndësi të posaçme janë shumë burime minerale si dhe ujërat termal në rrethin e Vinicës (Istibanja) dhe në rrethin e Shtipit (Kezhovica). Dëshmi plotësuese për një trashëgimi të pasur natyrore dhe mundësia për shfrytëzimin e saj janë disa rezervate natyrore: Goten, Linak, Mallesh, Zërnovska Reka, Lumi Ullomija; pastaj monumentet natyrore: Yvegori, Shpella Konjska Dupka, Morodvis, Maçevë, Cërna Topolla dhe shumë fshatra.



Në këtë rajon janë të njohura lokalitetet arkeologjike: Kalaja e Vinicës dhe Bargalla.

### Karakteristikat ekonomike


Rajoni Lindor, në vitin 2009 ka 14,9% PBV më të ulët për banorë se mesatarja e Republikës së Maqedonisë dhe është 2.777 €. Nga tetë rajonet e planifikuara gjendet në vendin e pestë dhe merr pjesë me 7,5% në krijimin e PBV-së në shtet. Si sektorë më të rëndësishëm në rajon dallohen: bujqësia dhe industria ushqimore, e tekstilit, këpucëtarisë dhe industria ndërtimore.

### Prioritetet e zhvillimit

1. Rritja e nivelit të zhvillimit ekonomik.
2. Infrastruktura moderne dhe strukturat e ndërtuara funksionale – hapësinore.
3. Rajoni lindor – destinacioni i njohur turistik.
4. Sektori konkurrues bujqësor.
5. Sigurimi i mjedisit të shëndoshë jetësor.
6. Avancimi i zhvillimit social.

Qendra për zhvillimin e rajonit lindor  
[www.rdc.mk/eastregion](http://www.rdc.mk/eastregion)

## Rajoni i planifikuar Juglindor



Rajonal juglindor gjendet në pjesën juglindore të Republikës së Maqedonisë dhe përbëhet dhe përbëhet nga pjesë kodrinoro – malore (më të vogla) dhe fushore (pjesa më e madhe). Lartësia mbidetare lëviz prej 64 deri më 2.157 metra (maja e Bregut të Gjelbër në malin Kozhuf). Ky rajon kryesisht karakterizohet me klimë mediterane, e cila gjatë tërë vitit kushtëzon me më shumë se 240 ditë me diell dhe është rajoni më me diell në vend.

Rajonin e planifikuar e përbëjnë 10 komuna me një sipërfaqe prej 2.739 km<sup>2</sup> dhe 172.693 banorë. Denduria mesatare e popullatës është 66 banorë km<sup>2</sup>, që është pak më e vogël se denduria mesatare në nivelin shtetëror. Pjesa më e madhe e popullatës (60%) jeton në 182 vendbanime rurale.

Rajoni i planifikuar kufizohet në jug me Greqinë (vendkalimet kufitare rrugore: Bogoridica dhe Dojrani Vjetër) dhe në lindje me Bullgarinë (vendkalimi kufitar rrugor në Novo Sellë).

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Bogdanci	114	8.523	4
2	Bosilova	150	14.132	16
3	Vallandova	331	11.929	29
4	Vasileva	221	12.525	18
5	Gjevgjelia	483	22.942	17
6	Dojrani	132	3.337	13
7	Konça	224	3.559	14
8	Novo Sellë	250	11.098	16
9	Radovishi	608	28.651	36
10	Strumica	322	55.997	25
	Gjithsej rajonet juglindore:	<b>2.739</b>	<b>172.693</b>	<b>188</b>

### Resurset natyrore

Ky rajon ka kushte të mira klimatike dhe tokësore për zhvillimin e bujqësisë dhe kultivimin e perimeve, posaçërisht perimet e hershme, ku ky rajon shquhet me një përvojë të madhe në vend. Kulturat dominuese janë: domatet, specat, kastravec, lakra, qepa, pjeperi dhe shalqiri. Në këtë rajon prodhohen 60% e nevojave të Republikës së Maqedonisë. Prodhimet tjera karakteristike janë molla japoneze dhe shega.

Liçeni i Dojranit është liçeni më i vogël natyror në Republikën e Maqedonisë dhe është i vetmi në këtë rajon, që funksionon si



ekosistem i izoluar me një florë dhe faunë shumë specifike, të cilat jetojnë në ambientin e tyre natyror pas gjendjes së mirë hidrologjike në vitet e fundit.

Resurset me të rëndësishme ujore janë lumenjtë Vardari dhe Strumica me rrjedhat e tyre rajonale, Liqeni i Dojranit dhe dy akumulimet e Luda Marës: Palirci dhe Çinarli. Ky rajon është i varfër me ujëra dhe gjendja e cilësisë dhe rrjedha e ujërave janë në ndikim të madh të kushteve klimatike.

Një pjesë e këtij rajoni karakterizohet me miniera të lëndëve të para minerale jometale: kuarci, gëlqerja, mermeri dhe argjila, dhe lëndët e papërpunuara jometalike minerale: hekur, zinku, bakri, ari, argjendi, kromi dhe uraniumi. Miniera për eksplotimin e feldspatit – hamzali, është i karakterit nitrik dhe është i vetmi në republikën e Maqedonisë dhe në Ballkan.

### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Trashëgiminë natyrore e përbëjnë: ujëvarat Rrëshinore dhe Kolashin, Liqeni i Dojranit dhe burimet termale, të cilat krijojnë një potencial të madh për zhvillimin e turizmit. Hidropotenciali termomineral e karakterizojnë dy vende shërimi të banjave: Banja Bansko, rrëzë malit Kozhuf, të dyja në një lartësi mbidetare prej 250 m dhe temperaturë të ujit prej 71° dhe 50°. Lokaliteti Kodra e Vardarit (vendbanim shumëshehtësësh nga shekulli XIII deri në shekullin I para erës sonë, banja romake në Bansko, manastiret në Vodoça dhe Velusa, si dhe karnavalet në Strumicë e rrumbullakojnë trashëgiminë kulturo – historike të këtij rajoni.


### Karakteristikat ekonomike

PBV-ja për banor në rajonin juglindor është 3.088 € (në vitin 20093) dhe për 15,4% më e ulët se mesatarja e Republikës së Maqedonisë. Merr pjesë me 8% në krijimin e PBV-së maqedonase dhe në grupin e tetë rajoneve të planifikuara zë vendin e katërt për nga zhvillimi. Sektorët më të rëndësishëm janë: bujqësia, blegtoaria, metalurgjia, industria ushqimore, turizmi dhe tregtia. Gjevgjelia - Las Vegasi maqedonas. Në këtë rajon ekziston një trend shumëvjeçar i organizimit të lojërave të fatit. Zhvillimi i këtij lloji të biznesit në vitet e fundit ka bërë që Gjevgjelia të trajtohet si Las Vegasi maqedonas. Në qytet ekzistojnë pesë kazino, në Dojran në mënyrë plotësuese punojnë dy kazino plotësuese, dhe janë në plan edhe ndërtimi i kasinove të reja. Të gjitha kasinotë janë investime të huaja.


### Prioritetet e zhvillimit

1. Të bëhen prodhime cilësore dhe me brend të kopshtarisë, prodhimet e vreshtarisë dhe pemëtarisë dhe përpunimet e kërkuara në tregjet rajonale dhe globale.
2. Të rritet numri i të punësuarve përmes zhvillimit të konkurrencës dhe zhvillimit të resurseve njerëzore.
3. Të zhvillohet infrastruktura e re dhe ajo ekzistuese, posaçërisht ajo lidhur me transportin, energjinë, IT, me qëllim të përkrahjes së rritjes ekonomike dhe ta përmirësojë konkurrencën e gjithëmbarshme.
4. Të zhvillohet turizmi i banjave, kulturo – historik, i fshatit dhe alternativ përmes bashkëpunimit me rajonet dhe shtetet fqinje.
5. Të mbrohet dhe të përmirësohet mjedisi jetësor përmes shfrytëzimit të burimeve të përtëritura të energjisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
6. Të promovohet rajoni dhe të tërhiqen investimet e drejtpërdrejta për një zhvillim të qëndrueshëm.

Qendra për zhvillimin e rajonit juglindor  
[www.rdc.mk/southeastregion](http://www.rdc.mk/southeastregion)



## Rajoni i planifikuar i Vardarit



Rajoni i planifikuar i Vardarit shtrihet në pjesën qendrore të Republikës së Maqedonisë dhe përfshinë rajonin e rrjedhës së mesme të lumit Vardar, rrjedhat e poshtme të degëve të Bregallnicës dhe Cërna Rekës pjesën e fundit perëndimore të Ovçe Poles. Përfshinë një sipërfaqe prej 4.042 km<sup>2</sup> ose 16% të territorit të vendit.

Në këtë rajon hyjnë 9 komuna në të cilat janë përqendruar 215 vendbanime me 153.837 banorë. Ky rajon shquhet me një denduri jashtëzakonisht të vogël të popullsisë nga 38 banorë/km<sup>2</sup> (na krahasim me mesataren e vendit nga 81 banorë/km<sup>2</sup>) dhe një përqendrim i madh i popullatës në mjediset urbane (rreth 69%).

Rajoni i planifikuar i Vardarit kufizohet me Greqinë në jug, por vendkalimi kufitar "Pulevec" akoma nuk është aktivizuar. Ky vendkalim kufitar mund të ketë rëndësi të jashtëzakonshme për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar me Greqinë, si dhe nxitjen e zhvillimit të rajonit, sepse vendkalimi kufitar do të siguronte qasje më të shpejtë të ski qendra Kozhuf.

	Komuna	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Banorët <sup>1</sup>	Vendbanimet
1	Velesi	427	55.051	29
2	Gradsko	235	3.629	16
3	Demir Kopia	309	4.159	15
4	Kavadari	992	39.008	40
5	Llozova	166	2.637	11
6	Negotina	478	19.411	19
7	Rosomani	132	4.142	10
8	Sveti Nikolla	483	18.153	33
9	Çashka	820	7.647	42
	<b>Gjithsej rajoni i Vardarit:</b>	<b>4.042</b>	<b>153.837</b>	<b>215</b>

### Resurset natyrore

Ky rajon ka kushte të shkëlqyera klimatike për zhvillimin e bujqësisë dhe vreshtarisë. Në këtë rajon (Tikveshia dhe rrethi i Demir Kapisë) ka 45% nga të mbjellat e përgjithshme të vreshtarisë në vend që e bën të njohur ndërkombëtarisht. Pos vreshtarisë, bujqësia karakterizohet edhe me një prodhim të fuqishëm special në: pemëtari (pjesëkat – të cilat kultivohen shumë në Rosoman dhe agrikultura (posaçërisht drithërat, si gruri dhe elbi) për të cilat kushte klimatike përgjigjet edhe pjesa e Ovçe Poles.

Nga resurset minerale në rajon rëndësi më të madhe ekonomike xehet e feroniklit, ku si të përfaqësuar janë: materialet ndërtimore për izolim, talku, kuarci dhe toka dyatomike. Resurse ujore në këtë rajon janë rrjedhat e poshtme të lumenjve: Vardari, Drini i Zi, Bregallnica, Babuna, Topolka dhe Otovica të cilat mundësojnë ndërtimin e gjashtë hidroakumulimeve, prej të cilave



tanimë janë ndërtuar tre: “Tikvesh”, “Lisiçe” dhe “Mlladost”.

Si potencial energjetik i këtij rajoni, me interes të veçantë është shfrytëzimi i hidropotencialit të lumit Vardar me projektin energjetik të luginës së Vardarit. Numri i madh i orëve të diellit në vitet (midis 2200 dhe 2800 varësisht nga lokacioni gjeografik), si dhe prania e rëndësishme e erërave (Ovçe Pole) krijon mundësi për prodhimin e energjisë nga burime të përtëritura.

#### Trashëgimia natyrore dhe kulturo – historike

Nga trashëgimia e pasur natyrore dhe kulturo – historike në rajon dallohen rezervati natyror “Tikvesh”, monumenti i natyrës “Demir Kapija” dhe lokalitetit arkeologjik “Stobi” të cilët paraqesin resurset më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Tradita shumëvjeçare në organizimin e vjelljes së rrushit së Tikveshit dhe prodhimit të verës mundësojnë edhe zhvillimin e turizmit të verës, ski qendra e sapondërtuar Kozhuf është më modernia në vend dhe në të ardhmen do të jetë bartëse e sporteve të dimrit.


#### Karakteristikat ekonomike

Rajoni i planifikuar i Vardarit ka një PBV prej 3.161 € për banorë (viti 2009/3), që është vetëm 3,1% më e ulët se mesatarja e Republikës së Maqedonisë. Ky rajon, zë vendin e tretë për nga zhvillimi dhe merr pjesë me 7,3% në krijimin PBV-së në Maqedoni. Si sektorë më të rëndësishëm në rajon dallohen: industria metalurgjike, ushqimore, e duhanit, tekstilit dhe industria e metaleve. Rajoni i Vardarit është rajon qendror në Maqedoni, nëpër të kalon korridori kryesor transportues në Ballkan (veri – jug) dhe paraqet një ndër udhëkryqet në Maqedoni (pas Shkupit, Velesit është njëra më e rëndësishme transportuese në Maqedoni), si në komunikacionin rrugor po ashtu edhe në atë hekurudhor.

#### Prioritetet e zhvillimit

1. Rritja e aftësisë konkurruese në rajon dhe sigurimi i fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të edukuar sipas nevojave të ekonomisë.
2. Zhvillimi i turizmit transit, të qëndrueshëm dhe kulturor.
3. Përmirësimi i infrastrukturës dhe potencialeve energjetike në rajon.
4. Zhvillimi rajonal i qëndrueshëm bujqësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural.
5. Zhvillimi i sistemit arsimor efektiv, të bazuar në vlera, do të jetë në gjendje t'i përgatit shfrytëzuesit për sfida jetësore.

Qendra e zhvillimit të rajoneve të planifikuara të Vardarit  
[www.vardarregion.gov.mk](http://www.vardarregion.gov.mk)



Burimet:

Popullata

<sup>1</sup> Enti Shtetëror i Statistikës: Kumtesa nr. 2.4.10.10 (korrik 2010) – Vlerësimet e popullatës më 31.06.2009 dhe 31.12.2009 sipas gjinisë dhe moshës, sipas komunave dhe rajoneve statistikore (NTES 3 viti 2007).

Shkalla a zhvillimit të rajoneve të planifikuara

<sup>2</sup> Vendimi për klasifikimin e planeve rajonale sipas shkallës së zhvillimit për periudhën 2008-2012, gazeta zyrtare nr. 162/2008

Të dhënat e PBV-së në rajonet e planifikuara

<sup>3</sup> Enti Shtetëror i Statistikës: Kumtesa nr. 3.1.11.03 (korrik 2011) – Prodhimi bruto i vendit dhe investimet në mjete themelore sipas rajoneve, 2009.





Republic of Macedonia  
Ministry of Local Self-Government



***Planning Regions in the Republic of Macedonia***

Skopje, 2011

## The planning regions' role in balanced regional development

The policy for balanced regional development is a system of objectives, instruments and measures directed at reducing regional disparities and achieving a balanced and sustainable regional development in the Republic of Macedonia. Through a process of promoting, managing and utilising the development potentials of the planning regions and the areas with specific development needs, the aim of the policy is to secure an integrated development of the country and to raise the quality of life by creating the conditions for equal access to public services. Realising the benefits of the European Union regional policy, the country has set up a system of measures and instruments that corresponds to European standards and creates the preconditions for a more efficient use of European Union funding.



The Law on Balanced Regional Development was adopted in 2007, and the Regional Development Strategy of the Republic of Macedonia in 2009. The Law establishes 8 planning regions in the Republic of Macedonia for the aim of planning regional development and implementing the measures and instruments for its promotion: Vardar, East, Southwest, Southeast, Pelagonia, Polog, Northeast and Skopje, as well as 8 regional development centres. Taking into consideration the need to have a statistical basis for planning development, the planning regions overlap with the statistical regions, defined in line with the Nomenclature of Territorial Units for Statistics as NUTS-3.

The planning regions differ according to their characteristic features. The largest region, Pelagonia, has the highest number of settlements (343), but is characterised by a low population density of 50 inhabitants/km<sup>2</sup>, while the smallest region, Skopje, has a high population density of 319 inhabitants/km<sup>2</sup> and contains more than ¼ of the total population. Most of the population lives in the large urban centres, which points to an unbalanced distribution of population within the regions. The Polog and the Southwest region are characterised by a larger percentage of rural population, while the rural areas in the other planning regions are more sparsely populated. This situation demonstrates the need to mitigate discrepancies in development and improve the quality of life in the planning regions.

Basic features of the planning regions

		Area km <sup>2</sup>	Population <sup>1</sup>	Population density inh/km <sup>2</sup>	Number of municipa- lities	Municipali- ties with seat in village	Number of settlement s	Urban population in 2002 (%)
	Republic of Macedonia	25,713	2,052,722	82	84	41	1,767	56.7
1	Vardar	4,042	153,837	38	9	4	215	68.7
2	East	3,537	179,846	51	11	3	217	66.3
3	Southwest	3,340	221,899	66	13	8	286	36.1
4	Southeast	2,739	172,693	63	10	5	188	45.3
5	Pelagonia	4,717	234,320	50	9	4	343	67.6
6	Polog	2,416	314,194	126	9	7	184	29.2
7	Northeast	2,310	174,876	75	6	3	192	56.6
8	Skopje	1,812	601,057	319	17	7	142	71.8

Level of development of the planning regions <sup>2</sup>

With the aim of laying down the foundations for the regional development policy, a classification of the planning regions according to the level of development was undertaken. The Decision on classification of the planning regions according to the level of development, adopted in December 2008, classifies the planning regions as follows:


